

KËRKESË

Nr. 2276/5, datë 25.5.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për marrjen në përdorim të përkohshëm dhe vendosjen e servitutit të përhershëm të kalimit, për pasuritë e paluajtshme që preken nga ndërtimi i Korridorit të Ndërtimit (pjesa e dytë), Sistemit të Gazsjellësit (pjesa e dytë) në zonat Korçë, Devoll, Berat, Skrapar, pjesë e projektit TAP. Subjekti kërkues i kësaj kërkesë është Trans Adriatic Pipeline AG Shqipëri, shoqëri e cila do zhvillojë një tubacion të gazit natyror, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim sipas listave emërore bashkëlidhur, mbi masën e vlerësimit të llogaritur në zbatim të Ligjit të Posaçëm nr. 116/2013, datë 15.4.2013, në përputhje me Planin e Rehabilitimit të Jetesës. Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në listat emërore të publikuara, si dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit dhe marrjes në përdorim të përkohshëm. Lutemi pronarëve dhe personave që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt, të dorëzojnë çdo dokument që disponojnë pranë ZVRPP-së përkatëse, mbi saktësimin dhe konfirmimin e pronësisë, sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Koli Bele

